

Konsultimet nacionale me komunitetin ligjor në Serbi për Iniciativën e themelimit të KOMRA-së

Beograd, Serbi

23. prill 2010.

Konsultimet nacionale me komunitetin ligjor në Serbi për Iniciativën e themelimit të KOMRA-së i organizoi Fondi për të drejtën humanitare. Konsultimet u mbajtën në Sallën solemne të Kuvendit komunal të qytetit në Beograd. Morrën pjesë 32 avokatë, shumica ishin juristë. Morrën pjesë edhe disa gjyqtarë (Snezhana Nikoliq Garotiq, gjyqtare në Gjykatën e Lartë në Beograd, dhe Miroslav Alimpiq, gjyqtar në Gjykatën e Lartë në Novi Sad, Dragan Janjiceviq, kryetar i Gjykatës së Lartë në Jagodinë, zyrtarë nga Departamenti për krime lufte në Gjykatën e Lartë në Beograd, Miolub Vitoroviq nga Prokuroria për krime lufte të Republikës së Serbisë, si dhe përfaqësues të misionit OSBE dhe Këshillit të Evropës në Serbi. Fjalën hyrëse e mbajti Natasha Kandiq (Fondi për të drejtën humanitare, Serbi), e cila edhe moderoi një pjesë të konsultimeve me emrin “Mandati, objektivat dhe marrëdhëniet KOMRA – gjykimet për krimet e luftës”. Dragan Popoviq (Iniciativa e të rinjëve për të drejtat e njeriut, Serbi), foli për atë se pse na duhet KOMRA. Për faktet e jetës dhe ligjore – identifikimin, kualifikimin, foli Jasminka Hasanbegoviq (profesoreshë në Fakultetin e Drejtësisë në Beograd, Serbi.)

Propozimet dhe opinionet e pjesëmarrësve/eve:

KOMRA do të parandalojë revizionizmin historik dhe relativizimin e krimit.

Pra, ky komision me gjetjet e tij mund të na paraqesë një pasqyrë të qartë të asaj çka ka ndodhë. Mund të na japë listën e qartë të viktimave, dhe jo vetëm listën, dhe jo vetëm renditjen e tyre në lista apo radhitje numrash, por edhe rrethanat e sakta nën të cilat secila viktima ka vdekë. Kjo, nga ana tjetër, do të parandalojë atë që sot po ndodhë në të gjitha ish-republikat jugosllave, e ai është revizionizmi historik dhe në anën tjetër relativizimi i të gjitha atyre krimeve, të cilët në vendin e caktuar apo grupit të caktuar, le të themi, që nuk ju pëlqejnë ose që nuk e pranojnë përgjegjësinë për ato ngjarje. (Dragan Popoviq, Iniciativa e të Rinjëve për të drejtat e njeriut, Serbi, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Iniciativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

KOMRA është shansi që të gjithë banorët e territorit të ish Jugosllavisë të dëgjojnë zërin e viktimave.

Ne, kështu me një organ/trup po ofrojmë atë që është e rëndësishme jetike për viktimat, e kjo është platforma publike për viktimat e krimeve të luftës, për viktimat e shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut. Ata do të kenë mundësinë që përmes një trupi të tillë si ky t’i drejtohen opinionit publik, që fjala e tyre të dëgjohet. Që ajo çka ata kanë përjetuar, që atë ta dëgjojnë të gjithë banorët e territorit të ish Jugosllavisë. (Dragan Popoviq, Iniciativa e të rinjëve për të drejtat e njeriut, Serbi, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Iniciativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

KOMRA nuk pretendon të dëshmojë një të vërtetë, por të krijojë një bazë serioze të dokumentacionit nga e cila do të nisen prokurorët, historianët dhe të tjerët të interesuar për të vërtetën.

KOMRA natyrisht se nuk pretendon, e as nuk mund të pretendojë në atë që të jetë ajo e cila do të dëshmojë të vërtetën e vetme të mundshme, dhe atë të vërtetën zyrtare. Natyrisht se diqka e tillë nuk

është e mundur, por ajo çka mundet KOMRA dhe duhet të bëjë, e ky është obligimi ynë njerëzor, qytetar, e veçanërisht për ne është obligim profesional, këtu mendoj në komunitetin tonë të avokatëve, para se gjithash, por mendoj edhe në disa profesione tjera, pra të sigurohet një bazë serioze e të dhënave të dokumentacionit, nga e cila do të nisen njerëzit e ndryshëm të interesuar për të vërtetën, marrëdhëniet e të vërtetës dhe avokatëve, jo vetëm për prokurorët por edhe për historianët, si dhe për njerëzit tjerë të interesuar. (Jasminka Hasanbegović, Fakulteti i Drejtësisë, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

Dokumentet të depozitohen në më shumë vende.

Unë ju lusë, që tërë këto dokumente të ndryshme, të mos ruhen vetëm në hapësirat (territorin) e ish Jugosllavisë, por të ruhen edhe diku tjetër. (Jasminka Hasanbegović, Fakulteti i Drejtësisë, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

Duhet të mundësohet t'u ipet fjala jo vetëm viktimave, por edhe atyre që janë përfshirë direkt, dhe të shiqohet edhe e vërteta e anës tjetër.

(...) qëllimi i këtij procesi të dokumentacionit është që secilit t'i ipet fjala. Dhe jo vetëm viktimat por edhe të gjithë tjerë që kanë qenë pjesëmarrës direkt, tu ipet fjala dhe mundësia që të perceptohet e vërteta subjektive, individuale, domosdoshmërisht edhe e vërteta e palës tjetër. Mendoj se të kuptuarit e tërë situatës nuk mund të arrihet nëse fokusohemi vetëm në konceptim të ngushtë të viktimave e pastaj edhe të ngjarjeve në përgjithësi. (Jasminka Hasanbegović, Fakulteti i Drejtësisë, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

Kontributi më i madhë i KOMRA-së është në funksionin e saj dokumentar.

Në këtë kuptim, kontributin më të madhë dhe të rëndësishëm, nëse doni më civilizues, historik, ligjor, kulturor, qytetar dhe politik, cilindo qoftë të KOMRA-së, unë parase gjithash, e shoh në krijimin e funksionit të saj të dokumentacionit. Ofrimin e mundësisë që secilit t'i ipet fjala dhe pastaj të gjitha këto të vërteta individuale të ruhen diku, dhe pastaj natyrisht avokatët do të gjykojnë relevancën për të drejtën, për veprimet, historianët do të gjykojnë, vlerësojnë relevancën për vërtetimin e të vërtetave historike, sociologët, psikiatrët duke studiuar patologjitë e ndryshme apo devijimet e ndryshme individuale të shoqërisë për hulumtimet e veta. Dhe natyrisht edhe opinioni publik do të ketë mundësinë të njihet me këto të vërteta. (Jasminka Hasanbegović, Fakulteti i Drejtësisë, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

Nëse puna nuk kryhet tani, fëmijët tanë do të ballafaqohen me vështirësitë me të cilat jemi ballafaquar ne.

Por, nesë tani kjo punë nuk kryhet, ne do të, në fakt jo ne por ata që do të vinë pas nesh, do të ballafaqohen me të gjitha këto vështirësi me të cilat jemi ballafaquar ne, kur është fjala për të vërtetën e luftërave ballkanike, përkundër disa dokumenteve të cilët janë fascinuese dhe për të cilët as nuk dihet,

sepse jemi mësuar që të na plasohet vetëm e vërteta historike zyrtare shtetërore. (Jasminka Hasanbegović, Fakulteti i Drejtësisë, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

Nuk mund të vihet deri te pajtimi pa përfshirjen e besimit/fesë.

Në rregull është nëse e kemi pajtimin për qëllim, por nuk mund të arrijmë deri te ky qëllim nëse nuk e përfshijmë edhe fenë/besimin në këtë proces. (Toma Fila, avokat, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

Bashkësitë Kishtare duhet të marrin pjesë në zgjedhjen e anëtarëve të KOMRA-së.

(...) kur të bëhet zgjedhja e anëtarëve të komisionit, duhet të ftohen bashkësitë kishtare që të marrin pjesë në te. (Vesna Petrović, Qendra e Beogradit për të drejtat e njeriut, Serbi, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

Varianti A është propozimi më i mirë për zgjedhjen e anëtarëve të KOMRA – parandalon kalkulimet dhe marrëveshjet politike.

Ajo e cila për mua është e rëndësishme dhe të cilën do ta veçoja si opcion thelbësor, është opcion i A, kjo më duket se se me të vërtetë kontribon në atë që vërtetë të parandalojë çfarëdo kalulime dhe marrëveshje politike në mes shteteve të ndryshme. Dhe ajo çka nuk më pëlqen në opcionin B është ajo mundësia që secili shtet atë ta bëjë vetë, dhe pastaj ata kandidatë mund të mos pranohen apo të vlerësohen si persona të qëlluar dhe të duhur për një komision të tillë, dhe prandaj ideja e rajonalizimit, sipas meje para se gjithash nënkupton që kjo disi të rregullohet në të njëjtën mënyrë në tërë rajonin. (Silvija Panović – Gjuriq, Këshilli i Evropës, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

Përfaqësuesit e BE dhe Këshillit të Evropës mund të ketë vetëm rolin këshilldhënës në KOMRA.

Një prej pyetjeve që u parashtruan këtu ishte se a duhet të jenë këtu pjesëmarrësit e Bashkësisë Evropiane dhe Këshillit Evropian, Kombeve të Bashkuara. Ndoshta PO si një, por vetëm në rolin e këshilldhënësit. Pra, më duket se ndoshta duhet të ekzistojë një mundësi në Statut se si të ndahen këto dy funksione. Sepse ndonjëherë njerëzit të cilët nga jashtë kanë qasje më objektive, më pak emotive, më pak të anagzhuar në tërë çështjen, prandaj ndonjëherë mund të jenë të dobishëm në këshilldhënje. (Silvija Panović – Gjuriq, Këshilli i Evropës, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

KOMRA nuk duhet të propozojë faljen e personit i cili shpreh pendim. Paraqitja e fakteve relevante duhet të trajtohet si rrethanë lehtësuese.

(...) nuk pajtohem me propozimin që Komisioni të propozojë faljen (amnestimin) për shkak se dikush pendohet. Më falni, por për mua kjo është absolutisht e papranueshme. (...) Prandaj pajtohem me propozimin parapak, e ajo është, se mund të mirret si rrethanë lehtësuese nëse ai person me paraqitjen e fakteve të caktuara dukshëm ndikon në zbulimin e të vërtetës në procedurën penale. (Silvija Panović – Gjuriq, Këshilli i Evropës, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

Qëllimi i KOMRA-së duhet të jetë ballafaqimi me të kaluarën përmes debateve publike, bashkëpunimit rajonal, procesimit të krimeve të luftës.

(...)do të duhej gjetur diçka më reale për arritjen e qëllimit, se sa që është arritja e pajtimit. Kjo realisht mund të jetë ballafaqimi me të kaluarën. (...) në debate publike, në bashkëpunim rajonal për procesimin, por jo vetëm para gjykatave të cilat janë kompetente për krimet e luftës, por edhe para gjykatave të cilat, të themi, janë kompetente për çështjet e krimit të organizuar. (Aleksandar Resanović, Zyra e Komisionerit për informacion publik, Serbi, Beograd, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

Dhe, tani pas Rezolutës për Srebrënicën, gjithashtu dezhevimi i krimeve në Srebrenicë duhet të jetë vepër e dënueshme. (Rajko Gurić, Këshilltar i Lartë i Mbrojtjes së Qytetarëve të Serbisë, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

KOMRA duhet të sjellë rekomandimet për ngritjen e reparacionit për viktimat e krimeve të luftës.

Mendoj se një ndër rolet më të rëndësishme, siq po e shoh unë, të cilën do ta kishte Komisioni, është hartimi i propozimeve për ngritjen e reparacionit në të gjitha vendet, e posaqërisht këtu te ne. Andaj, mendoj se do të ishte e duhur të bëhet një lloj edukimi, gjegjësisht përafrimi i konceptit të reparacionit, në mënyrë që opinionit tonë publik gjegjësisht organeve gjyqësore në mënyrë që të kuptojnë kompensimin e dëmit, zakonsiht kompensimi i dëmit nuk është i njejtë si reparacioni. Shprehja e reparacionit ka kuptim më të gjerë dhe gjithpërfshirës dhe ndikim në publik, gjithashtu edhe te viktimat e luftës dhe të shkeljes së drejtave të njeriut në përgjithësi. (Tanja Drobnjak, avokate, Beograd, Serbi, Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

Zakonsiht mundësitë e gjykatave janë të kufizuara, prandaj është mirë të ekzistojë Iniciativa për KOMRA-në

Vizioni im i një bashkëpunimi mes KOMRA-së dhe organeve gjyqësore ka dy aspekte. Njëri është gjithësesi aspekti i njohur i vjetër, për ate se, është shumë mirë për organet gjyqësore ekzistimi i një Iniciative të tillë, sepse është plotësisht e qartë që gjykatat e rregullta të ne, në këtë mendoj edhe në gjykatën e Tribunalit, dukshëm mund të kontribuojnë në vërtetimin e disa të dhënave të besueshme për viktimat dhe faktet. Megjithatë disa mundësi të gjykatave janë mjaftë të kufizuara. Kësi Iniciativa mund të ofrojë një bazë më të gjerë të dhënave dhe për këtë arsye është e rëndësishme të përkrahen iniciativa të tilla. (Miroslav Alimpić, gjykatës në Gjykatën e Lartë në Novi Sad, Serbi, Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

KOMRA mund tu ndihmojë prokurorive të gjejnë prova të reja shtesë.

Sipas mendimit tim, iniciativa e tillë, kjo mënyrë e mbledhjes së fakteve, dëshmia publike e viktimave është një lloj presioni në gjykatat dhe prokurorinë. Me këtë nuk po mendoj asgjë të keqe, mendoj se është mirë që në një mënyrë të ndikohet në këtë kuptim në gjykata dhe në prokurori, të kuptojnë se ku munden tjetër të gjejnë prova për të filluar procedurat adekuat, sepse deri tash jemi ballafaquar me situata kur gjykatat dhe prokuroritë kanë pasë shumë probleme në sigurimin e fakteve/provave

relevante. (Miroslav Alimpiq, gjykatës në Gjykatën e lartë në Novi Sad, Serbi, Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

Respektimi i të vërtetës së tjerëve është kusht për ballafaqimin me të kaluarën dhe pajtimin.

Respektimi i tjetrit dhe të tjetrës, mendoj se ky është hapi i parë me të cilin ne duhet të ballafaqohemi. Në fakt, jemi mjaft largë këtij hapi të parë i cili është kusht për hapin e dytë për ballafaqimin me të kaluarën, e pastaj edhe pajtimin. Në fakt, kur them tjetrit dhe të tjetrës mendoj në aspektin e personalitetit tjetër dhe të tjetrit, në kuptimin e kulaifikimeve tona të atij pjesëmarrësi, dhe nëse doni ta themi edhe në kuptimin e të vërtetës së tjetrit. (Jasminka Hasanbegović, Fakulteti i Drejtësisë, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

Të definohet periudha kohore që do ta përfshijë KOMRA, dhe për sa kohë duhet ta kryejë tërë punën.

Kur flasim për periudhën kohore këtu duhet qartë të definohet se në cilën periudhë kohore duhet të kryhet e tërë puna, apo të definojmë në çfarë periudhë kohore, sepse nga kjo periudhë kohore në të cilën do të funksionojë komisioni e tëra mvaret nga mundësitë e fokusimit në çështje të caktuara, në periudhë të caktuat kohore.

Nëse shkohet në kohën e viti 1943, mendoj se kjo është një periudhë shumë e gjatë kohore dhe me shumë ngjarje, si dhe mundësia potenciale që të tërhiqet vëmendja e medijave dhe njerëzve që janë në komision nga ajo që është qëllim primar tani, e ajo është e kaluara e afërt dhe ngjarjet të cilat kanë ndodhë në territorin e ish Jugosllavisë, kështuqë mendoj se nuk është lehtë të ndërlidhen këto, dhe sa vështirë është të definohen ngjarjet relevante në të cilat do të fokusohen nga ajo periudhë kohore, sepse ose është njëra ose të dyja së bashku, edhe pse kurrë nuk do të kryhen të dyja së bashku. (Marko Karagjiq, Ministria e të drejtave të njeriut dhe të pakicave, Republika e Serbisë, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

Komisioni duhet ta ketë mundësinë të paraqesë akuza penale.

Komisioni duhet të ketë autotitetin, gjegjësisht mundësinë që të paraqesë akuza/kallëzime penale. (Marko Karagjiq, Ministria për të drejtat e njeriut dhe të pakicave, Republika e Serbisë, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

Esenca e Komisionit është që të mos harrohet, e jo pajtimi i cili është akt individual.

Për shembull, mendoj se nuk është mirë të insistohet në atë se ajo do të sjellë deri te pajtimi, sepse pajtimi është akt individual, personal, lidhje e individit me ngjarjen. Është e drejtë e imja të pajtohem apo jo, të falë apo të mos falë. Mendoj se esenca e komisionit është që të mos harrohet. (Silvija Panović – Gjuriq, Këshilli i Evropës, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

(...) poqese gjyqësia në të gjitha vendet e rajonit do ta kishte kryer punën e vetë deri në fund, atëherë KOMRA ndoshta nuk do të duhej të ekzistonte. Por kjo nuk ka ndodhë. Kriminelët kanë mbetë pa u ndjekur dhe pa u dënuar, shumë prej tyre. Prandaj KOMRA është e nevojshme. (Velimir Lipovan, avokat,

Kikindë, Serbi, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

Viktimat të cilat do të dëshmojnë, si dhe anëtarët e KOMRA-së, duhet të kenë mbrojtje.

Ne jemi dëshmitarë se gjykimi në Tribunalin e Hagës pas të cilës qëndrojnë institucione të fuqishme, nuk ka mundësi të përfundojë gjykimet, si ai ndaj Ramush Haradinajt për shkak të presioneve në dëshmitarë. Pra, këtu duhet të flasim për sigurinë jo vetëm të anëtarëve të komisionit por edhe të personave të cilët vinë të dëshmojnë. (Velimir Lipovan, avokat, Kikindë, Serbi, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

Të përkujdesimi që pas KOMRA-së të ekzistojë organi i cili do të bëjë presion në shtetet të zbatojnë rekomandimet.

Nuk jam e sigurtë se do të jetë e mundur të detyrohen, gjegjësisht nën mandatin e KOMRA-së të vëhet se KOMRA ka mundësinë të japë rekomandime obligative, por që padyshim është përgjegjësi edhe e kreaortëve të KOMRA-së, por edhe e shoqërisë civile dhe shoqatave profesionale, komunitetit ligjor e gjithashtu edhe e shoqatave të viktimave të mendojnë për formimin e një instance (organi) pas përfundimit të punës së komisionit e cila do të bëjë presion në shtetet që ti realizojnë rekomandimet apo së paku të inicojnë zbatimin e tyre. (Mirjana Toma, Impunity Watch, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

Fokusi i KOMRA-së të jetë në rastet gjyqësore të pashqyrtuara.

Qëllimi i vetëm i themelimit të KOMRA-së është që të shqyrtohen rastet gjyqësore të cilat deri tani kanë qenë në zonën e hirtë, dhe të cilët kanë qenë deri tani të pashqyrtuara. (Tomislav Vishnjq, avokat, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

Është me rëndësi të definohen raportet mes KOMRA-së dhe shteteve në mënyrë që të shmangen pengesat e mëvonshme.

Këtu është me rëndësi që menjëherë në fillim të definohen marrëdhëniet mes KOMRA-së dhe shteteve në mënyrë që të shmangen, në fakt që të parandalohet mundësia në fazat e mëvonshme që të mos ketë pengesa. Gjithashtu është e rëndësishme që në aspektin financiar të aktivitetëve të caktuara të KOMRA-së menjëherë të definohen obligimet shtetërore, por cili është obligimi i KOMRA-së. (Tomislav Vishnjq, avokat, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

Reparacionet dhe qëllimet tjera sekondare të KOMRA-së të lihen për fazën pas zbulimit të fakteve.

Që reparacionet ose pasojat sekondare të punës së KOMRA-së do të duhej ose të lihen për ndonjë fazë tjetër ose të hiqen nga rezultatet përfundimtare. Sepse thjeshtë thelbi dhe baza e suksesit të KOMRA-së do të jetë efikasiteti i bashkëpunimit me shtetet të cilat duhet të japin përkrahjen për te. (Tomislav Vishnjq, avokat, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

Problem do të jetë dhënja e dokumenteve shtetërore dhe zbatimi i urdhërave për arrestim.

(...) urdhëri për dhënjen e dokumenteve dhe urdhëri për arrestimin e personave, këto janë dy kompetenca të rëndësishme shtetërore për të cilat tani dikush duhet të negociojë me shtetet në rajon.

(Tomislav Vishnjq, avokat, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).

Të vogla janë gjasat që KOMRA të obligojë gjykatat territoriale të lëshojnë urdhër-arrest të dëshmitarëve. Komisioni duhet vetë t'i ftojë dëshmitarët.

Mendoj se gjasat janë minimale që KOMRA të arrijë të obligojë gjykatat në shtete të cilat do të marrin pjesë në këtë, që të lëshohet urdhër-arrest për ndonjë person. Është shumë vështirë që gjykatat të pranojnë territoriale që komisioni të caktojë kënd duhet ta arrestoj gjykata. Gjyqi e jep urdhërin kur duhet dikush të arrestohet jo për procese gjyqësore, por për dëshmi te komisioni. Mendoj se shumë më reale është që komisioni ta dërgojë ftesën për dëshmi, dhe se këtu është thelbësorja se njerëzit vullnetarisht duan të dëshmojnë apo duan të flasin për atë çfarë u ka ndodhë. Dhe pastaj duhet pyetur ata a duan të dëshmojnë edhe në procesin gjyqësor. (Miroslav Alimpiq, gjykatës në Gjykatën e Lartë në Novi Sad, Serbi, Konsultimet Nacionale me komunitetin ligjor për Inicativën e themelimit të KOMRA-së, Beograd, Serbi, 23. Prill 2010).